



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 29/ 10 / 2025

PROCES - VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 29.10.2025”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:**

1. Erion Gjoshi
2. Erjon Qafa
3. Nexhip Elezi
4. Bujar Blloku
5. Fadil Zdrava
6. Libeta Kotorri
7. Ismail Paja
8. Gezim Gjoshi
9. Nertila Uruçi
10. Gazeli Hysa
11. Aleksander Idrizi
12. Blerim Kuqja
13. Aurjola Bezati
14. Ardjan Allkja
15. Avni Shtylla

- Mbledhja drejtohet nga Blerim Kuqja ,N/Kryetar i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja e këshillit bashkiak,propozohet që të futet në rend dite një projekt vendim i ri nga drejtoria e finances. Miratohet rendi i ditës me 11 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës për miratimin e proces verbalit. Miratohet me 11 vota pro p/verbalit i mbledhjes së kaluar.
- Kalojmë te pika e 5-të e rendit të ditës dhe miratohet me 12 vota pro dhe 1 kundër 6% për muajin shtator.

- Diskutohet pika nr.3 e rendit të ditës, Miratim mandati për Avni Tele Shtylla .Miratohet me 13 vota pro dhe bëhet betimi i këshilltarit përpara Këshillit Bashkiak.
- Kalojmë pika nr.4 e rendit të ditës, Miratim mandati për Ardjan Ali Allkja .Miratohet me 13 vota pro dhe bëhet betimi i këshilltarit përpara Këshillit Bashkiak.
- Anëtarët e rinj bëhen pjesë e mbledhjes,përkatësisht njëri anëtar i grupit të PS dhe njëri anëtar i grupit të PD.
- Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës, “Për miratimin e vlerës financiare të dëmëve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në fshatin Dëshiran,në banesën e z. Hyqmet Çarçiu. Prezanton p/vendimin Endrit Gjoshi.
- E.Gjoshi : Personi ka humbur jetën dhe Bashkia do t’i riparojë shtëpinë.
- Nertila Uruçi: Duhet trashëgimia ligjore që dikush të kërkojë shpërblim në emër të të ndjerit.
- Për mungesë dokumentacioni propozon Z.Blerim Kuqja që të kalojë për mbledhjen e ardhshme. Hidhet për votim dhe shtyhet për mbledhjen e ardhshme.
- Kalojmë te pika nr.7 për miratimin e vlerës financiare për humbje jete. Edhe ky p/vendim kalon për shqyrtim për mbledhjen e ardhshme.
- Kalojmë te pika shtesë e rendit të ditës “Për miratimin e shtesës së buxhetit për shpërblimin e zjarrfikësve”.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro dhe 1 abstenim
- Diskutojmë 3 pikat e të ndryshmeve dhe automatikisht kalojnë për vitin e ardhshëm sepse Bashkia nuk ka fond të parashikuar për ndihma financiare për 2025.
- N.Uruçi: Kam kërkuar vendosjen e 2 policave të shtrirë dhe nuk kam përgjigje.
- N.Uruçi: Problem tjetër janë edhe qentë e rrugës (endacakë). Gjithashtu kërkojmë informacion për rrugët që janë shtruar nga Dr. e Urbanistikës.
- Ismail Paja: Në zbatim të urdhrit të kryeministrit kërkojmë interpelancë me përgjegjësin e IMT për pastrimin e territorit mbledhjen e ardhshme. 2) Kërkojmë informacion nga Dr. e Bujqësisë për rrugët e arave.
- Gazeli Hysa: U shtrua para dy muajsh dhënia me qira e palestrës. A është dhënë me qira?
- Endri Pepa: Është konfirmuar nga prefektura ,por nuk është lidhur kontrata.
- I.Paja : Është një eskavator në njësinë kajan (në territorin e njësisë) . Pse nuk largohet nga qendra e njësisë? Kërkojmë informacion.
- Bujar Blloku: Është hapur muri te njësia administrative Kajan dhe futen makina. Kërkojmë informacion nga administratori i njësisë Kajan.
- **Mbyllet mbledhja me 4 vendime të miratuara.**

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA